VENDIM
Nr. 86, datë 24.4.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GREENNAT SOLAR PARK BALLSH" SHPK, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET KONTRATËS SË HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 2, germa "a", 3, 4, germat "a" dhe "b", 5, germa "j", 6, 7 dhe 8 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1475/1 prot., datë 23.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'GreeNNat Solar Park Ballsh' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj",

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit:

- Shoqëria "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 100 mw, për një afat 25-vjeçar, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier.

- Në vijim, me vendimin nr. 223, datë 23.10.2024, Bordi i ERE-s vendosi disa ndryshime në lidhje me vendimin nr. 132/2024, duke përcaktuar se shoqëria do të ushtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për kapacitetin e instaluar prej 25 mw dhe për kapacitetin e plotë prej 100 mw jo më vonë se data 11.1.2028.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1475 prot., datë 8.4.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruese kolaterali financiar) të aseteve të shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k., si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur:

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të neneve 2, germa "a", 3, 5, germa "j" dhe 6 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licencuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1:

- Germa "a": shoqëria duhet të sjellë ekstraktin historik të saj.

- Germa "c": shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare të saj dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve.

- Germa "d": shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores, në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve.

- Germa "e": shoqëria duhet të informojë në lidhje me garantimin e shlyerjes së kredisë, si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

- Germa "f": shoqëria duhet të informojë në lidhje me efektet e pritshme, në lidhje me transferimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë.

- Germa "h": shoqëria duhet të depozitojë kontratën e kredisë nr. 1687 rep., nr. 714 kol., datë 3.4.2025, si dhe të përditësojë/depozitojë, kontratën e hipotekës me listën e detajuar të aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar me vlerat respektive dhe totale, sipas përcaktimeve të rregullores. Gjithashtu, në këtë kontratë nuk parashikohet gatishmëria e shprehur nga ana e bankës për të rishikuar përcaktimet në marrëveshjen e nënshkruar në rast mosmarrjeje miratimi nga ERE, ndaj në vijim do t'i bëhet me dije shoqërisë/bankës për të vlerësuar qëndrimin e tyre.

- Germa "i": shoqëria duhet të paraqesë në ERE deklaratën nga banka, e cila duhet të shprehë gatishmërinë që të garantojë vetë, apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar në rast të transferimit të aseteve.

- Germa "j": shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pasur transferime të kryera më herët nga ana saj.

- Pika 3: sa konstatuar kontrata e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk e përmban një detyrim të tillë, gjithsesi shoqëria duhet të sqarojë nëse ka informuar MIE-n për këtë kërkesë dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës të komunikimit.

- Pika 6: shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun, ndaj do t'i kërkohet kjo në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga "Kontrata e kredisë" nr. 1687 rep., nr. 714 kol., datë 3.4.2025, lidhur ndërmjet "Raiffeisen Bank" sh.a., në cilësinë e kredidhënësit dhe shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "GreeNNat Solar Park Ballsh sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti